



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:001953

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05834290

KPPP.nr. 7/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit DESIGN LIFTS Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810838071 dhe me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ibadete Xhafa Kuçi, avokate nga Suhareka, kundër debitorit Galeria Shopping Mall Sh.P.K., me numër unik identifikues 810095837 dhe me seli në Graçanicë, rruga Graçanicë – Llapnasellë, km. 3, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Ismaili, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 177/23 e datës 12.12.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi nga Prishtina, jashtë seancës me datën 19.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Galeria Shopping Mall Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 177/23 i datës 12.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 78.00 (shtatëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit DESIGN LIFTS Sh.P.K., me datë 12.12.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 177/23, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturë Nr. 23-SHV04-001-120, e datës 25.08.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij urdhri në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,082.50 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe

shpenzimet e procedurës përbarimore dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përbarim në shumë prej 104.00 EUR.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përbarimor, me arsyetim se kreditori dhe debitori kanë lidhur kontratë për kryerjen e shërbimeve për furnizim dhe instalim të ashensorëve, shkallëve lëvizëse dhe shiritave lëvizëse, ashtu që në fillim kanë pasur probleme të vazhdueshme me ashensorë, duke i shkaktuar vështirësi sepse edhe vizitorët kanë shfaqur ankesa dhe pakënaqësi për shkak të mos funksionimit të ashensorëve. Duke qenë se kreditori nuk ka kryer shërbimet ndaj debitorit, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përbarimore, sipas tarifës së OAK-së.

Kreditori, përmes përfaqësues së autorizuar në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të faturës si dokument i besueshëm, e që përmban të gjitha elementet të cilat përcaktohen me dispozita ligjore. Ka shtuar se çdo reagim karshi punës dhe servisimeve ka qenë korrekt dhe në kohë, andaj problemet në ashensor nuk janë lidhur me mos punën dhe mos reagimin e kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përbarimore dhe atë në emër të propozimit për përbarim në shumë prej 104.00 EUR dhe të përgjigjes në prapësim në shumë prej 208.00 €, sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet*

në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura Nr. 23-SHV04-001-120 e datës 25.08.2023, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përbarimit pasi që është e përshtatshme për përbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se kreditori nuk i ka përmbushur obligimet sipas kontratës për kryerjen e shërbimeve të datës 06.09.2018 pasi që qysh nga viti 2023 kanë filluar problemet e vazhdueshme me ashensorët të cilët disa herë kanë qenë jashtë funksionit dhe se për shkak të kësaj gjendje dhe për vonesë në riparimin e tyre debitori ka lëshuar fatura për kompensim dëmi, por që pretendime të tilla të natyrës materiale, nuk janë objekt shqyrtimi në procedurën përbarimore, procedurë kjo e cila i nënshtrohet formalitetit rigoroz ku gjykata kufizohet vetëm në vlerësimin e elementeve formale të dokumentit mbi bazën e të cilit inicohet procedura përbarimore dhe ligjshmërisë së urdhrit për lejimin e përbarimit.

Andaj në rastin konkret, meqenëse fatura është pranuar nga debitori dhe atë pa asnjë kundërshtim, rezulton se ky i fundit është pajtuar me detyrimin që derivon nga kjo faturë por që përkundër kësaj, debitori nuk ka asnjë pengesë që lidhur me pretendimet e tij për mos zbatim të kontratës nga kreditori, të inicioj kontest të rregullt juridik civil.

Si përfundim, meqenëse debitori nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tij, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit, gjykata nuk e ka parë të arsyeshme caktimin e një seance dëgjimore me qëllim të vërtetimit të validitetit të prapësimit, andaj në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësueses së kreditorit në emër të përgjigjes në prapësim në vlerë prej 78.00 € konform rregullores në fuqi për tarifatat e OAK të vitit 2017, për parashtresat lidhur me përbarimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 7/24, datë 19.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.